



Nr.regj.14834/12

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Sevdije Gashin duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Izedin Sabit Bytyqi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 .parg.1,e lidhur me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, Ligji nr.04/L-050 e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.**02.07.2012** merrë këtë,

#### **A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI: Izedin Sabit Bytyqi** i lindur me 10.06.1977 në Prishtinë, ku edhe tani jetonë në Rr"Meto Bajraktari"nr.24,i pa maruar,i gjendjes së mesme ekonomike,ka të krye fakultetin,Udhëheqes i Divizionit për Buxhet dhe Financa pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

#### **Ë s h t ë p ë r g j e g j e s**

Sepse si Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në Prishtinë,nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë për vitin 2011, pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë i njohuar se është i përfshirë në Listën e Zyrtarve,të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë nga pozita që e mban.  
Me veprim të këtillë ka kryer kundërvajtje nga neni 8 parag.1,e sanksionuar me neni 17 parag.1.1. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë:

#### **D E N O H E T**

Me gjobë në të holla në shumë prej **2300 ( dymij e treqin )** Euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë. Në dobi të të hyrave Gjyqësore të Kosovës,në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.  
Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, i njëjti do ti zëvendësohet në denim me burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke ju llogaritur 15 EURO në një ditë burgimi.  
Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.Në emer të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EURO, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.  
Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit,kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës  
Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

#### **A r s y e t i m**

**Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë**,me kërkesën nr.01-1616/2012 të parashtruar gjykatës me datën 02.07.2012 për inicimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të permendur me lartë,dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës, ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse dhe në séanceë verbale ka ndëgjuar të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi: Eshtë e vertet se nuk e kam bërë deklarinimin e pasurisë pranë Agjencionit Kunder Korrupsionit,dhe pse e kam pranue një imell nga Nazmije Krasniqi,e cila më ka informue se jam i obliguar që ta bejë deklarinimin e pasurisë,unë kam menduar se është ardh gabim,nuk e kam marrë seriozisht dhe e kam fëshij nga boksi,duke menduar se nuk mu ka drejtue mua.

03-2385/12/02  
fuj

2.

Unë jam që 3 vite Udhëheqes i Divizionit për Bugjet dhe Financa pranë Ministrisë Perkatëse, dhe nga ky pozitë asnjëher nuk e kam bërë deklarinimin e pasurisë.

Gjykatësi thirri në cilësinë e deshmitarit Enis Sadikun i autorizuari i Agjencionit Kunder Korrupsionit, i cil deklaron se Izedin Krasniqi ka qenë i njohtuar se është i obliguar që ta bejë deklarinimin e pasurisë sipas Ligjit 04/L-050, në të cilin Ligj shruan "se janë të obliguar të gjithë udhëheqsit e financave të bejnë deklarinimin e pasurisë"

Gjykatësi pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurit, deklaratës së deshmitarit, dhe provave të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresave tjera të lëndës, pastaj edhe faktit se i pandehuri e parnon vet se ka qenë i njohtuar mbi obligimin që e ka pas sipas Ligjit për deklarinimin e pasurisë, e denoj të pandehurim me denimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin shqiptimit dhe caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari vlersoj të gjitha rrethanat nga neni 7 i LMK-së nën të cilat është krye kundërvajtja, dhe të pandehurit ia shqiptoj kë lloj denimi duke llogaritur se do të arrihet efekti i sanksionimit, i bindur që i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryej kundërvajtje të këtillë ose të ngjajshme

Konform neni 109 al.2 të LMK-së caktohen shpenzimet e procedurës kundërvajtëse.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.**

Gjyqtari  
Murat Paçarada



